

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje tuba dhe rakorderi”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Tubacione të ujit të pijshëm - 44162500-8.

Materiale hidraulike - 44115210-4.

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.564.925 *(katër milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet e pesë)* **lekë pa T.V.Sh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë;

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e L.P.P., si dhe në nenin 43, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2/ c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20% të vlerës limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që Operatori Ekonomik ofertues zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumenteve të tilla si certifikata ISO ku operatori ekonomik duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatat:

- a) **ISO 9001:2015** – Certifikim për Menaxhimin e Cilësisë, ose ekuivalente (e vlefshme); për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standardi tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO; **(Këto dokumente duhet të jene të përkthyer dhe noterizuar);**
- b) **ISO 14001:2015** – Certifikim për Sistemi i Menaxhimit Mjedisor, ose ekuivalente (e vlefshme); për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarde evropiane e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standardi tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO; **(Këto dokumente duhet të jene të përkthyer dhe noterizuar);**

Argumentimi: Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të; nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“...3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

- a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*
- b) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u*

referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj"...

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik",

"4...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...".

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar) konkretisht:

"...1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...".

Gjithashtu referuar; nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoriteteve në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në tërësi.

Zbatimi i një sistemi të menaxhimit mjedisor lejon kompanitë të menaxhojnë në mënyrë sistematike aspektet specifike mjedisore të të gjithë aktivitetëve, me qëllim të promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimit mjedisor të proceseve prodhuese.

ISO 9001 përfaqëson standardin ndërkombëtar unanim i njohur si standardi që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standard aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

ISO 14001 përfaqëson standardin ndërkombëtar unanim i njohur si standardi që i përket kërkesave për një sistem të menaxhimit mjedisor. Ky standard aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

Gjithashtu, këto certifikata janë të nevojshme për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ushtron aktivitet në pajtueshmëri me standardet e kërkuara të cilësisë, duke garantuar në këtë mënyrë se furnizimi i mallrave do të realizohet sipas standardeve ndërkombëtare.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

2.5 Për të verifikuar përputhshmërinë e materialeve të kërkuara me specifikimet teknike të përcaktuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra në ambientet e Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a., me adresë: Lagjia Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë në ditën e hapjes së ofertave datë 12.05.2023, ora 11:30', për mallrat e përcaktuara në Shtojcën nr.6 në Dokumentat e Tenderit (D.T.)

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të germës “a” pika 6 e nenit 40 të V.K.M.- së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “...Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentoj kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose...”.

Njësia e Prokurimit në përcaktimin e këtij kriteri mbështetet në faktin se për të verifikuar përputhshmërinë e materialeve të kërkuara, me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit (D.T.) është e domosdoshme paraqitja e mostrave, për materialet e kërkuara si më sipër. Mostrat janë kërkuar dhe konsiderohen të nevojshme për tu verifikuar në lidhje me cilësinë e tyre dhe a janë sipas standardit që nevojitet për tu vendosur në rrjetin dhe pajisjet e Ujësjiellësve në administrimin e Autoritetit Kontraktor.

Për këtë arsye, referuar llojit dhe funksionit që ato kanë, kërkesa për paraqitjen e këtyre mostrave, vlerësohet e nevojshme dhe e mjaftueshme për realizimin e synimit të Autoritetit Kontraktor duke mos rënduar pozitën ekonomike të operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

2.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqes një deklaratë për garancinë e mallrave sipas përcaktimet në listën e specifikimeve teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “...Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës...”.

Njësia e Prokurimit, për shkak të llojit dhe natyrës së mallrave objekt prokurimi, si dhe në mbështetje të specifikimeve teknike të hartuara, konsideron të nevojshme përcaktimin e këtij kriteri duke paraqitur një deklaratë mbi garancinë e mallrave për furnizimin e duhur dhe për funksionalitetin e tyre.

Sqarim për ofertuesit: Në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” Neni 82 dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, Neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, Autoriteti Kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në Nenin 82, të LPP-së dhe Nenit 26 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Në çdo rast, Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të noterizuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për objektin e prokurimit: “Blerje klori”.

Specifikimet teknike gjenden pjesë përbërëse e D.T. në S.P.E. e A.P.P.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT